

VENDIM
Nr.159, datë 2.3.2011

PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT,
NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË
INSTITUTIN E STUDIMEVE EUROPIANE, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS,
NË VITIN AKADEMIK 2010 - 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuotës së pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, të doktoratës, në Institutin e Studimeve Europiane, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2010 - 2011, gjithsej 50, të ndarë sipas programeve të studimit, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-----------|
| a) Doktoratë në “Legjislacion dhe institucionet e BE-së” | 15 kuota; |
| b) Doktoratë në “Politika dhe qeverisja në Europë” | 15 |
| kuota; | |
| c) Doktoratë në “Diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të BE-së” | 20 |
| kuota. | |

2. Në kuotën e çdo programi studimi të doktoratës caktohen dy kuota për kandidatët nga trojet jashtë kufijve.

3. Tarifa e shkollimit, për çdo program të studimeve të doktoratës në Institutin e Studimeve Europiane të Universitetit të Tiranës është 204 600 (dyqind e katër mijë e gjashtëqind) lekë, e cila paguhet në këste, të përcaktuara nga Universiteti i Tiranës.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Rishpërndarja e kuotave të paplotësuara bëhet me urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha